

Komponenti 11: “Studimi i Efektivitetit të Menaxhimit të Integruar në 10 ferma me aktivitet të përzier”

Rekomandime të përgjithshme (të pjeshme)

Për rritjen e efektivitetit ekonomik të fermave të përziera familjare duhet:

1. Të hapet një dokumentacion i plotë ekonomik dhe zooteknik për fermat.
2. Të bëhet regjistrimi i rregullt i të gjithë treguesve të prodhimit, blerjeve, shtitjeve dhe gjithë aktivitetit të fermave.
3. Të bëhet llogaritja e bilancit të ushqimeve të nevojshme për gjithë vitin sipas kategorive dhe mbi bazën e tij të hartohet struktura e mbjelljes së foragjereve.
4. Të bëhet manipulimi, trajtimi, përpunimi dhe përdorimi në sasi të maksimale të mundshme i plehrave dhe mbeturinave të tjera organike në fermë me qëllim rritjen e rendimentit, përmirësimin e strukturës së tokës, minimizimin e përdorimit të plehrave kimike sintetike në bimët foragjere, minimizimin e ndotjes së mjedisit dhe garantimin e ushqimeve të sigurta për fermerin dhe konsumatorin.
5. Të bëhet mbajtja e viçave femra për remont dhe për shitje si material racor të çertifikuar të racës “Oberental” dhe “Simental” në fermat pilot me qëllim rritjen e numrit të krerëve që mbarështohen dhe rritjen e të ardhurave të fermës me rreth 30% .
6. Përdorimi i plehrave kimike sintetike të bëhet vetëm mbi bazën e analizave agrokimike të tokës dhe bilancit të plehërimit për çdo kulturë foragjere, në bashkëpunim me specialistët.
7. Të futen në strukturën e mbjelljeve e bimëve të tilla foragjere si perko, burxhak, sorgum, si bimë me rendiment të lartë dhe me vlera të larta ushqyese, jo vetëm për sigurimin e ushqimit më cilësor për kafshët që mbarështohen, por dhe për realizimin e qarkullimeve bujqësore dhe përmirësimin e strukturës së tokës dhe mbrojtjen e mjedisit.
8. Mbjellja e bimëve foragjere të bëhet brenda afateve optimale me qëllim minimizimin e infeksioneve nga sëmundjet, dëmtuesit dhe barërat e këqija dhe përdorimin minimal të pesticideve.
9. Përdorimin e kryqëzimeve industriale me raca mishi si Simental, Sharole, Limuzinë, Blu Belge, etj.
10. Zgjatja e periudhës së majmërisë së viçave nga 3-4 muajsh në 9 muajsh dhe zbatimi i racioneve ushqimore të rekomanduara për të arritur një shtesë peshe 900-1000 gr/ditë, me qëllim rritjen e të ardhurave të fermës me rreth 50%.

Tabela 1. Racioni ushqimor ditor i sugjeruar për viçat në majmëri për një shtesë peshe 900-1000 gr/ditë

Nr	Ushqimet	Racioni fizik kg/krerë	Nj.U/kg	Proteina gr/kg	NjU ditore	NjQ ditore	Proteina gr
1	Jonxhë e thatë	6.00	0.50	70	3.00	2.49	420
2	Koncéntratë	4.00	1.18	67	4.72	3.91	268
3	Bar i thatë	5.00	0.54	39	2.60	2.15	195
4	Panxhar foragjer	3.00	0.23	7.0	0.69	0.57	21
	Shuma	18.00	2.45		11.01	9.12	904

11. Të përmirësohet racioni ushqimor ditor dhe gjithëvjeter i lopëve të qumështit dhe mëshqerrave të remontit me qëllim rritjen e rendimentit/krerë, sipas rekomandimeve të literaturës. Racionet ushqimore të rekomanduara sipas kategorive dhe nivelit të prodhimitarisë jepen në tabelat 2-5.

Tabela 2. Racioni ditor i rekomanduar për lopët me prodhimitari 8-10 kg qumësht/krerë/ditë

Nr	Llojet e ushqimeve	Sasia në kg fizik	Lëndë e thatë (kg)	Energji (NjQ)	Proteina (PTZE) (gr)	Kalcium (Ca) (gr)	Fosfor (gr)
1	Bar jonxhe	4.00	3.40	2.28	320.10	51.00	9.00
2	Silazh misri me kalli	7.50	2.25	2.02	149.00	4.88	5.93
3	Kashtë gruri	1.50	1.32	0.56	58.80	2.64	1.32
4	Elb	0.50	0.43	0.50	45.00	0.40	2.25
5	Misër	1.00	0.85	1.10	103.00	0.36	4.00
6	Hime gruri	1.00	0.87	0.73	74.00	1.80	16.00
7	Kripë gjelle	0.030	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Totali		15.530	9.12	7.19	749.9	61.08	38.50

Tabela 3. Racioni ditor i rekomanduar për lopët me prodhimitari 15-20 kg qumësht/krerë/ditë

Nr	Llojet e ushqimeve	Sasia në kg fizik	Lëndë e thatë (kg)	Energji (NjQ)	Proteina (PTZE) (gr)	Kalcium (Ca) (gr)	Fosfor (gr)
1	Bar jonxhe	8.00	6.80	4.55	639.20	102.00	17.00
2	Silazh misri me kalli	15.00	4.50	4.05	297.00	9.75	11.85
3	Kashtë gruri	3.00	2.64	1.11	116.16	5.28	2.64
4	Elb	1.00	0.85	1.00	89.00	0.80	4.50
5	Misër	2.00	1.70	2.20	206.00	0.72	8.00
6	Hime gruri	3.00	1.74	1.46	148.00	3.60	32.00
7	Kripë gjelle	0.030	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Totali		32.030	18.23	14.37	1495.36	122.15	75.99

Tabela 4. Racioni ditor i rekomanduar për lopët me prodhimitari 25-30 kg qumësht/krerë/ditë

Nr	Llojet e ushqimeve	Sasia në kg fizik	Lëndë e thatë (kg)	Energji (NjQ)	Proteina (PTZE) (gr)	Kalcium (Ca) (gr)	Fosfor (gr)
1	Bar jonxhe	10.00	8.50	5.7	799.00	127.50	21.25
2	Silazh misri me kalli	20.00	6.00	5.4	396.00	13.00	21.10
3	Kashtë gruri	3.00	2.64	1.11	116.16	5.28	2.64
4	Elb	2.00	1.70	2.00	178.00	1.60	9.00
5	Misër	3.00	2.55	3.30	309.00	1.08	12.00
6	Hime gruri	2.00	1.16	1.46	148.00	3.60	32.00
7	Kripë gjelle	0.030	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Totali		40.030	22.55	18.97	1946.16	152.06	97.99

Tabela 5. Racioni ushqimor i rekomanduar për viçat femra të remontit të moshës 90-300 ditë

Nr	Ushqimet	Racioni fizik kg/krerë	NjU/kg	Nj/U	NjQ	Proteina gr
1	Bar jonxhe	4.0	0.50	2.00	1.66	280
2	Misër	1.0	1.18	1.18	0.97	67
3	Hime	1.0	0.61	0.61	0.50	65
4	Bërsi soje	1.2	0.63	1.26	1.04	193
5	Silazh misri	10.0	0.20	2.00	1.66	70
6	Bar i thatë	1.0	0.54	0.54	0.44	39
	Shuma	18.2	3.66	7.59	6.27	714

12. Duke studiuar tregun në lidhje me çmimin e shitjes së qumështit, në bashkëpunim me shërbimin veterinar duke përdorur preparate hormonale për stimulim, të bëhet spostimi ose grupimi i përkohshëm i pjelljeve të lopëve në kohën kur çmimi është më i lartë për fermerët që nuk kanë kontrata të rregullta tregtimi.

Drejtuese e Komponentit

Dr. Elizabeta SUSAJ

Fushe Kruje, me 12.02.2009